

## PANAIRI I NJOHURIVE 2018

### Integrimi i Mënyrave të Reja të Mësimdhënies dhe të Nxënit në Arsimin dhe Formimin Profesional

25 - 26 Maj 2018

Tirana International Hotel

Strategjia e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) për rritjen e cilësisë së arsimit dhe formimit profesional bazohet në përdorimin e Mënyrave të Reja të të Nxënit përmes Mësimin të Kombinuar. Kombinimi i metodave të ndryshme të të nxënit ku njëra prej të cilëve është mësimi online, lejon individualizimin e përvojave për zhvillimin e aftësive të përqendruara tek nevojat e nxënësve. Për të siguruar një menaxhim sa më efikas të shkollës, janë futur në përdorim edhe sistemet e digjitalizuara të informacionit. Kjo risi në sistemin arsimor në Shqipëri është projektuar nga ekspertë të shquar kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe bazohet tek modeli shumë i suksesshëm i arsimit dhe formimit profesional në Zvicër.

Gjatë procesit të trajnimit dhe mentorimit nga projekti S4J në periudhën Janar 2017 - Maj 2018, u vërtetua se shumë mësues të arsimit profesional janë kthyer në përdorues të rregullt të mënyrave të reja. Në punën e tyre, këta mësues kombinojnë përvojat e të nxënit në shkollë dhe në kompani, përfshijnë arsyetimin kritik, vlerësimin nga bashkëmohatarët, të nxënit përmes projekteve ndërdisiplinore, projekteve kërkimore, lojërave, zhvillimin gradual të aftësive praktike dhe aktivitete të tjera që vendosin nxënësin në qendër, duke synuar arritjen e rezultateve të të nxënit dhe rritjen e punësueshmërisë së nxënësve. Ata përdorin standardet e industrisë; kurse online pa pagesë dhe Sistemet Virtuale të të Nxënit të përshtatura për sistemin shqiptar të AFP-së; mediat sociale; kanë akses në materiale mësimore digjitale të përditësuara, të zhvilluara sipas modelit me në qendër nxënësin; si dhe komunikojnë në kohë reale përmes pajisjeve elektronike.

Në Prill të vitit 2018, S4J mori çmimin special të mirënjohjes nga juria e "Albanian ICT Awards" për punën e shkëlqyer dhe vizionin modern për konceptimin e shkollave profesionale në Shqipëri. "Panairi i Njohurive 2018" do të demonstrojë këtë risi në mësimdhënie dhe nxënie në shkollat e Arsimit Profesional në Shqipëri, duke ofruar mundësi për shkëmbimin e praktikave më të mira dhe shtrirjen e zbatimit të të nxënit të kombinuar në shkollat partnere dhe më gjerë.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC



swisscontact

**Data:** 25 maj 2018, 16.00-18.30  
26 maj 2018, 09.00-17.00

**Vendi i organizimit:** Hoteli 'Tirana International'

**Numri i pjesëmarrësve:** rreth 200

**Objektivat:**

- Demonstrimi i praktikave më të mira, novatore dhe gjithëpërfshirëse të mësimdhënies dhe të nxënies në shkollë dhe kompani;
- Nxjerrja në pah e konceptit të projektit S4J dhe e frymës zvicerane për mënyrat e reja të mësimdhënies, të nxënies dhe punës;
- Stimulimi i menaxhimit të njohurive, i të nxënies nga bashkëmoshatarët dhe i komuniteteve të praktikës në AFP;
- Nxitja e zhvillimit të përbashkët dhe e përvojës unike për audiencën;
- Dhënia e kontributit në dialogun kombëtar për zhvillimin e aftësive dhe reformën në punësim.

**Pjesëmarrësit:**

- Mësues, nxënës dhe drejtues të institucioneve partnere ofruese të AFP-së dhe më gjerë;
- Institucionet qeveritare përgjegjëse për novacionin dhe AFP-në;
- Punëdhënës dhe shoqata të biznesit;
- Partnerë strategjikë që mbështesin integrimin e standardeve të industrisë në AFP;
- Komuniteti ndërkombëtar i interesuar në fushën e zhvillimit të aftësive.

**Karakteristika të aktivitetit:**

- Fjala e mirëseardhjes nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Certifikimi i mësuesve në "Bazat e Didaktikës" nga Agjencia Kombëtare të AFP dhe Kualifikimeve
- Prezantime teknike nga profesionistë të nivelit të lartë;
- Prezantimi i praktikave më të mira: demonstrime, animacione, simulime;
- Dëshmi nga nxënësit;
- Debat konstruktiv me audiencën në lidhje me nevojën për mënyrat e reja të të nxënies dhe mënyrën e rritjes së motivimit dhe punësueshmërisë së nxënësve;
- Seminare pune dhe prezantime ndërvepruese për të angazhuar audiencën gjatë aktivitetit;
- Mjedis nxitës.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC**



swisscontact

**PROGRAMI**

Dita e parë, 25 maj 2018

15:30 – 16:00	<b>Regjistrimi</b>	Stenda e regjistrimeve, Kati 1
16:00 – 16.40	<b>Ceremonia e hapjes</b> <i>Dokumentar i shkurtër mbi ‘Mënyrat e Reja të të Nxënit’</i>	Salla ‘Akernia’ Kati 1
	<b>Fjala e Mirëseardhjes</b> <i>Fation Dragoshi, Menaxher i projektit ‘Aftësi për Punë S4J’</i> <i>Dajna Sorensen, zv. Ministre e Financave dhe Ekonomisë</i> <i>Teuta Dobi, Trans- Adriatic Pipeline</i> <i>Phillipp Keller, zv. Ambasador i Zvicrës në Shqipëri</i>	
16:40 – 17.00	<b>Certifikimi i 56 mësuesve e instruktorëve për “Bazat e Didaktikës në AFP”</b> <i>Video e shkurtër mbi Trajnimin Didaktik</i>	Salla ‘Akernia’ Kati 1
	<i>Ejvis Gishti, Drejtore, Agjencia Kombëtare e AFP dhe Kualifikimeve</i> <i>Florida Toto, Mësuese, Kristo Isak</i>	
17:00– 17.15	<b>Prezantim</b> <b>Rezultatet e aplikimit të Mënyrave të Reja të Mësimdhënies e të Nxënit në AFP</b> <i>Skerdi Zahaj, Universiteti i Tiranës</i>	Salla ‘Akernia’ Kati 1
17.15 – 17.35	<b>Prezantim</b> <b>Të mësosh dhe punosh në epokën digjitale: eksplorimi i mënyrave të reja të përdorimit të teknologjisë</b> <i>Urs Gröhbiel, Rrjeti Zviceran i Novacionit në Arsim (SNBI)</i>	Salla ‘Akernia’ Kati 1
17.35 – 18:30	<b>Njohje e pjesëmarrësve me njëri-tjetrin dhe Kafe</b> <i>Vizitë në stendat e portofoleve didaktike të mësuesve të certifikuar</i>	Salla ‘Akernia’ Kati 1

Dita e dytë, 26 maj 2018

Aktivitetet paralele - Prezantime dhe Diskutime në Panel

09.00 – 11.00 **Modeli i Praktikave Profesionale në Distançë në TIK, Eksperienca dhe Rezultatet**

Salla 'Teuta'  
Kati 2

98 nxënës të klasës së 10-të të degës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në shkollën 'Kolin Gjoka' në Lezhë dhe Industriale 'Pavarësia' në Vlorë janë praktikantë në 11 kompani novatore të TIK në Shqipëri, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e programimit dhe marketimit digjital. Edhe pse në vendndodhje të ndryshme, grupet e nxënësve, të udhëhequr nga mentorët e kompanive dhe të koordinuar nga mësuesit, përfitojnë nga trajnimi në praktikë nëpërmjet zhvillimit të projekteve dhe detyrave. Rrjeti menaxhohet në mënyrë virtuale nga platforma për menaxhimin e detyrave "Papion". Nxënësit dhe kompanitë takohen virtualisht çdo javë përmes komunikimit në video në kohë reale në internet.

**Kontribues**

Dorian Kamberi & Ines Troqe, 'Aftësi për Punë' S4J

Jetmir Shtjefni, mësues, shkolla 'Kolin Gjoka'

Fjora Hodo, mentore, Albanian Business Partner (ABP)

Jurgen Vuka, praktikant pranë ABP dhe nxënësi i TIK, shkolla 'Kolin Gjoka'

09.00 – 11.00 **Të mësuarit nëpërmjet projekteve ndërlëndore**

Salla 'Metropol'  
Kati 2

Të nxënësit nëpërmjet projekteve zbatohet gjerësisht në shkollat profesionale partnere të projektit. Nxënësit janë mjaft proaktivë në propozimin dhe projektimin e projekteve. Mësuesit luajnë një rol të rëndësishëm në planifikimin, ndjekjen dhe vlerësimin e duhur të punës me projekte. Në këtë aktivitet do të prezantohen raste të projekteve ndërdisiplinore, nga ku do të dalin në pah edhe problemet kryesore që kanë të bëjnë me planifikimin e duhur dhe integrimin e kësaj metode në programet shkollore.

**Kontribues**

Shqipe Shyti, eksperte e Metodologjisë së Mësimdhënies

Alba Qirjako, mësuese, Shkolla Industriale 'Pavarësia'

Anisa Melishte, mësuese, shkolla 'Gjergj Canco'

Ledi Lacej, mësuese, shkolla 'Hamdi Bushati'

Ermira Mani, mësuese, shkolla 'Hamdi Bushati'

Alketa Ismailaj, mësuese, shkolla Tregtare



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC



swisscontact

09.00 – 11.00 **Modeli i mësimdhënies dhe të nxënimit me nxënësin në qendër**

Salla 'Onufri'  
Kati 2

Me qëllim angazhimin e nxënësve dhe kthimin e mësimdhënies dhe të nxënimit në një proces më ndërveprues e më efektiv, mësuesit përpiqen të planifikojnë orë mësimore me në qendër nxënësit. Kjo seancë do t'i kushtohet ilustrimit të rasteve të mësuesve, të cilët kombinojnë një sërë metodash, do të shpjegojnë bazën logjike që qëndron pas këtij kombinimi, si edhe sfidat dhe efektivitetin e tij sipas vrojtimeve.

**Kontribues**

Gerda Sula, eksperte e Pedagogjisë dhe Trajnimit të Mësuesve  
Selman Feraj, mësues, shkolla Industriale 'Pavarësia'  
Elda Polovina, mësuese, shkolla 'Kristo Isak'  
Joana Halili, mësuese, shkolla industriale 'Pavarësia'

09.00 – 11.00 **Procesi i zhvillimit të materialeve mësimore digjitale**

Salla 'Blu'  
Kati 2

'Aftësi për Punë' S4J po investon në mbështetjen e mësuesve të shkollave partnere ofruese të AFP-së për zhvillimin e materialeve mësimore digjitale dhe ngarkimin e tyre online. Materiale për rreth 75% të temave të lëndëve teorike në degët Hoteleri-Turizëm, TIK dhe Ekonomi janë duke u testuar. Lëndët e arsimit të përgjithshëm, si për shembull matematika, janë rikonceptuar duke integruar materiale interaktive dhe tërheqëse. Procesi mbështetet nga trajnimi i akredituar i mësuesve dhe bashkëpunimi me ekspertë pedagogjikë, lëndorë dhe ekspertë të të nxënimit virtual, si dhe bazohet në modelin e sigurimit të cilësisë.

**Kontribues**

Mirela Andoni, eksperte e AFP-së  
Teuta Çobaj, eksperte e Sigurimit të Cilësisë në Arsim  
Rezart Prifti, drejtues, Qendra për Sipërmarrje & Inovacion (CEI)

11:00 – 11.30 **Pushim Kafë**

Holl, Kati i 2-të

11:00 – 11.30 **Vizita të organizuara në stenda:  
Teknologjia CISCO, NetAcad dhe projekte të nxënësve  
Projekte novatore të realizuar nga nxënësit**

Holl, Kati i 2-të

Aktivitete paralele - Prezantime dhe Diskutime në Panel

11.30 – 13.00 **CISCO, integrimi i standardeve industriale në TIK**

Salla 'Teuta'  
Kati 2

Me qëllim ekspozimin e lartë ndaj teknologjisë sipas standardeve të industrisë dhe platformave virtuale të të nxënimit, 'Aftësi për Punë' S4J ka krijuar partneritet

strategjik me CISCO, duke u kthyer në Akademi Rrjeti (Network Academy) e CISCO-s.

15 mësues janë certifikuar si instruktorë CISCO dhe NetAcad përdoret nga mësuesit dhe nxënësit, i integruar në kurrikulat shkollore dhe si aktivitete jashtëshkollor. Partneriteti koordinohet përmes Universitetit Amerikan në Kosovë (AUK), i cili mbështet shkollat dhe 'Aftësi për Punë' S4J për të trajnuar mësuesit të shfrytëzojnë më së miri akademinë. Laboratori CISCO është bërë qendra e shumë projekteve novatore të nxënësve.

#### **Kontribues**

Henry Leerentveld, Drejtor për Evropën Lindore, Swisscontact  
Agjensia Kombëtare e AFP dhe Kualifikimeve  
Enis Vehapi, Universiteti Amerikan i Kosovës  
Lorena File, mësuese, shkolla industriale 'Pavarësia'  
Ronaldo Feka, nxënës, shkolla industriale 'Pavarësia'  
Qendra Shumëfunktionale Kamëz

11.30 – 13.00 **Përdorimi i platformës 'Metronom' në mbështetje të mësimdhënies dhe të nxënimit**

Salla 'Metropol'  
Kati 2

'Aftësi për Punë' S4J, në bashkëpunim me CEI (Qendra për Sipërmarrje dhe Inovacion), ka mundësuar aksesin dhe përdorimin nga shkollat profesionale të një platforme mësimore të bazuar në sistemin Moodle. Mësuesit e shkollave partnere të 'Aftësi për Punë' S4J trajnohen dhe instruktohen për mënyrën e përdorimit të funksionaliteteve të kësaj platforme në mbështetje të mësimdhënies dhe të nxënimit. Përdorimi i wikis (faqe interneti të përbashkëta për një komunitet përdoruesish), testimi në kohë reale, përmbajtjet digjitale interaktive, portofoli i punëve të nxënësve, leximi individual, statistikave, etj., janë vetëm disa nga përparësitë e kësaj platforme. Mësuesit dhe ekspertët do të shpjegojnë mënyrën e përdorimit të kësaj platforme si edhe rezultatet e deritanishme.

#### **Kontribues**

Ana Shkreta, menaxhere, Qendra për Sipërmarrje & Inovacion (CEI)  
Gerda Sula, eksperte e Pedagogjisë dhe Trajnimit të Mësuesve  
Valbona Cokaj, mësuese, shkolla 'Kolin Gjoka'  
Griselda Llanaj, nxënëse, shkolla Tregtare

11.30 – 13.00 **Kontekstualizimi i lëndëve të kulturës së përgjithshme me profesionin**

Salla 'Onufri'  
Kati 2

Lëndët e kulturës së përgjithshme përfaqësojnë të paktën 30% të ngarkesës mësimore në shkollat profesionale. Megjithatë i njëjti program zbatohet në të



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicrane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC



swisscontact

*gjitha drejtimet profesionale, mësuesit e shohin si të dobishëm integrimin e elementeve nga profesioni dhe kontekstualizimin, duke arritur kështu edhe objektivat mësimore.*

**Kontribues**

*Shqipe Shyti, eksperte e Metodologjisë së Mësimdhënies  
Erjona Jaupaj, mësuese, shkolla Tregtare  
Shpresa Gjergji, mësuese, shkolla Tregtare  
Zamira Shehaj, mësuese, shkolla Tregtare*

**11.30 – 13.00 Sistemet dhe teknologjia në mbështetje të menaxhimit institucional**

**Salla 'Blu'  
Kati 2**

*Me mbështetjen e 'Aftësi për Punë' S4J, për 4 shkolla profesionale është vënë në dispozicion sistemi elektronik i informacionit për menaxhimin e shkollës. Informatizimi i të gjitha të dhënave shkollore si aktiviteti mësimor, burimet dhe administrimi, do të mundësojë raportim më të shpejtë dhe më efikas, por edhe kontroll të performancës nga të gjithë aktorët.*

**Kontribues**

*Orland Qesteri, 'Aftësi për Punë' S4J  
Alba Halilaj, Communication Progress  
Gjenovefa Xhakaj, mësuese, shkolla Tregtare*

**13.00 – 13.45 Vizita të organizuara në stenda:  
Teknologjia në mbështetje të 'Mënyrave të Reja të të Nxënit'  
Projekte novatore të realizuara nga nxënësit**

**Holl, Kati i 2<sup>të</sup>**

**13.00 – 14.00 Pushim dreke**

**Holl, Kati i 2<sup>të</sup>**

*Aktivitete paralele - Prezantim dhe Diskutim në Panel*

**14.00 – 15.30 Përdorimi i lojës për të mësuar në mënyrë më efektive**

**Salla 'Teuta'  
Kati 2**

*Të nxënit nëpërmjet lojërave është një qasje edukative që synon motivimin e nxënësve për të mësuar duke përdorur elementet e lojës gjatë orës mësimore. Disa prej këtyre elementëve mund të jenë të mbështetur nga teknologjia e informacionit. Qëllimi i kësaj qasjeje është të maksimizojë kënaqësinë dhe angazhimin nëpërmjet sigurimit të interesit të nxënësve dhe frymëzimit të tyre për të nxënë edhe më tej.*

*Në shkollat partnere të 'Aftësi për Punë' S4J, të nxënit nëpërmjet lojës po bëhet gjithnjë e më i zakonshëm. Mësuesit e lidhin këtë aktivitet me rezultatet e të nxënit dhe krijojnë atmosferë të mirë për të mbështetur procesin e të nxënit.*

### **Kontribues**

Gerda Sula, eksperte e Pedagogjisë dhe Trajnimit të Mësuesve  
Jonida Haxhi, mësuese, shkolla 'Gjergj Canco'  
Nertila Dundo, mësuese, shkolla 'Kristo Isak'

14.00 – 15.30 **Planifikimi, vlerësimi dhe dokumentimi i 'Të mësuarit përmes punës'  
nëpërmjet përdorimit të mediave digjitale**

Salla 'Metropol'  
Kati 2

Sigurimi i cilësisë së të nxënësve nëpërmjet punës është vendimtar, sidomos në rastet kur pjesa më e madhe e këtij aktiviteti ofrohet në kompani. Të kushtëzuar nga faktorë të ndryshëm kontekstualë si pozita gjeografike, infrastruktura e shkollës, apo marrëdhëniet me sektorin privat, drejtime të ndryshme profesionale në institucionet partnere ofruese të AFP-së ndjekin praktika të ndryshme në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënësve.

### **Kontribues**

Elsa Denaj, 'Aftësi për Punë' S4J  
Meri Simoni, mësuese, shkolla 'Kolin Gjoka'  
Majlinda Haxhi, mësuese, shkolla 'Gjergji Canco'  
Merita Koço, mësuese, shkolla Tregtare  
Shembuj nga ofrues të tjerë

14.00 – 15.30 **Mësimdhënia dhe të nxënësve gjithëpërfshirës – vlerësimi i vazhduar dhe ndjeshmëria gjinore në AFP**

Salla 'Onufri'  
Kati 2

Portofoli i nxënësve konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e vazhduar, veçanërisht në AFP, ku nxënësit marrin pjesë në aktivitete të ndryshme dhe fitojnë aftësi shtesë.

Një çështje tjetër e rëndësishme që lidhet me të nxënësve gjithëpërfshirës në AFP ka të bëjë me ndjeshmërinë gjinore. Vajzat kanë përfaqësim të ulët në AFP dhe shpesh në aktivitetet mësimore, duke përfshirë edhe vlerësimin, vërehen praktika të njëanshme gjinore. 'Aftësi për Punë' S4J synon ta trajtojë këtë çështje nëpërmjet qasjes së integruar të lehtësuar edhe nga koordinatoret për çështjet gjinore në secilin institucion ofrues partner.

### **Kontribues**

Eriola Shingjergji, 'Aftësi për Punë' S4J  
Teuta Çobaj, eksperte e Sigurimit të Cilësisë në Arsim  
Lorena Gjonçe, mësuese, shkolla Tregtare  
Ina Hoxha, mësuese, shkolla 'Gjergj Canco'



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC



REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E FINANÇAVE  
DHE EKONOMISË



swisscontact



14.00 – 15.30 **'Mësimi i Kombinuar' në Arsimin dhe Formimin Profesional – gjetja e zgjidhjes sipas qëllimit dhe kushteve**

Salla 'Blu'  
Kati 2

*Thelbi i të Nxënit të Kombinuar qëndron në përshtatjen e modelit të mësimdhënies dhe të nxënit me rezultatet mësimore dhe kushtet e mësimi. Kurset afatshkurtra dhe programet e mësimi për të rriturit janë pjesë e rëndësishme e ofertës së AFP-së, veçanërisht në këto kohë sfiduese ku bota e punës ndryshon me ritme të shpejta. Platformat e të nxënit elektronik dhe përfshirja e sektorit privat në hartimin e moduleve/kurseve, janë vetëm disa nga risitë në këtë proces, të cilat mund të aplikohen si në shkollat profesionale, ashtu edhe në qendrat e formimit profesional.*

**Kontribues**

Bora Bajrami, 'Aftësi për Punë' S4J  
Klajdi Myzaferaj, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik, Vlorë  
Erjon Curraj, Tech 360  
Irma Allceniku, mësuese, shkolla 'Hamdi Bushati'

15.30 – 15.45 **Pushimi dhe Kafe**

Holl, Kati i 2-të

15.45 – 16.30 **Diskutim në Panel  
Trajnimi i mësuesve dhe zhvillimi i kurrikulës – roli i Njësisë së Zhvillimit & aktorëve të tjerë**

Salla 'Balsha'  
Kati 2

**Kontribues**

Gerda Sula, eksperte e Pedagogjisë dhe Trajnimit të Mësuesve  
Rezart Prifti, drejtues, Qendra për Sipërmarrje & Inovacion (CEI)  
Mirela Andoni, eksperte e AFP-së  
Gentian Boçi, drejtor, Shkolla Industriale 'Pavarësia'  
Enis Vehapi, Universiteti Amerikan i Kosovës

16.30 – 16.45 **Rezultatet e Konferencës  
Sidita Dibra, Zëvendës menaxhere e projektit 'Aftësi për Punë' S4J**

Salla 'Balsha'  
Kati 2

16.45 – 17.00 **Mesazhet përmbyllëse  
Henry Leerentveld, Drejtor për Evropën Lindore, Swisscontact**

Salla 'Balsha'  
Kati 2